



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS
OSNOVNI SUD U MITROVICU – BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.292/2012

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si kontestimore e përbërë nga gjyqtari individual Faton Ademi dhe procesmbajtësja Elheme Peci, në çështjen juridike të paditësit i [] nga fshati [] i Poshtëm-Komuna e Mitrovicës, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. [] kundër të paditurit [] me vendbanim/vendqëndrim të panjohur, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm Av. [], për vërtetimin e pronësisë mbi bazën e shitblerjes dhe mbajtjes, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor me datë 03.07.2014, në të cilin ishin të pranishëm i autorizuari i paditësit dhe përfaqësuesi i përkohshëm i palës së paditurit, me datë 11.08.2014 nxjerrë këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit [] nga fshati [] i Poshtëm-Komuna e Mitrovicës kundër të paditurit [] me vendbanim/vendqëndrim të panjohur.

II. VERTETOHET se paditësi [] nga fshati [] i Mitrovicës është pronar mbi bazën e shitblerjes dhe mbajtjes me mirëbesim i parcelës kadastrale P-71208042-010008-0 me sipërfaqe prej 4411 m², në vendin e quajtur [] Zona Kadastrale- [] i Poshtëm, e cila evidentohet me numër të lëndës 15-950-17103.

III. OBLIGOHET i padituri [] që në afat prej 15 ditësh pas pranimin të këtij aktgjykimi t'ia lejoj paditësit [] që këtë të drejtë ta regjistroj në regjistrat përkatës kadastrale pranë organeve kompetente, në të kundërtën ky aktgjykim paditësit i shërben si bazë për regjistrim të së drejtës së pronësisë.

IV. Shpenzimet e procedurës i bartë paditësi.

A r s y e t i m

Paditësi [] nga fshati [] i Poshtëm-Komuna e Mitrovicës ka parashtruar padi me datë 06.12.2012 kundër të paditurit [] me vendbanim/vendqëndrim të panjohur me të cilën ka kërkuar vërtetimin e pronësisë mbi bazën e shitblerjes dhe mbajtjes.

Në seancën përgatitore paditësi i ka propozuar gjykatës që të paditurit ti caktohet përfaqësuesi i përkohshëm ngase ai nuk ka mundur ta siguroj adresën e vendbanimit/vendqëndrimit për të paditurin.

Gjykata pasi ka kërkuar shënime nga organet kompetente rreth adresës dhe është siguruar se adresa e të paditurit është e panjohur, andaj bazuar në nenet 79 par.3 pika(a), 82 par.1 dhe 2, 387 par.1 pika(q) të LPK-së të njëjtit ia ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm Av..

Në seancën e datës 15.04.2014 i autorizuari i paditësit deklaroi: mbetem në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, propozoj që gjykata të vazhdoj me nxjerrjen e provave me dëgjimin e dëshmitarëve nga fshati Vinarc i Poshtëm dhe gjithashtu nga fshati i Poshtëm-Komuna e Mitrovicës si dhe të sigurohet dalja e gjykatës në vend së bashku me ekspertin e gjeodezisë.

Po të njëjtën seancë përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit deklaroi: e kundërshtoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, por nuk e kundërshtoj administrimin dhe nxjerrjen e provave.

Gjykata aprovoj propozimin për dëgjimin e dëshmitarëve dhe propozimin për daljen në vend së bashku me ekspertin gjeodet.

Në seancën e daljes në vend të datës 28.04.2014 gjykata ia caktoj ekspertit Ing.Nehat Sahiti detyrat dhe e obligoj të njëjtin që ekspertizën e hartuar me shkrim t'ia prezentoj gjykatës.

Në seancën e rradhes në të cilën ishte i pranishëm edhe eksperti që e kishte përpiluar ekspertizën me shkrim, i autorizuari i paditësit dhe përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit deklaruan se nuk kanë vërejtje për ekspertizën gjeodezisë të dhënë me shkrim.

Sipas propozimit të autorizuarit të paditësit gjykata vazhdoj me procedimin e dëshmitarëve dhe

I autorizuari i paditësit në fjalën përfundimtare deklaroi: pas ekspertizës gjeodete e bëj precizimin e kërkesëpadisë përkitazi me sipërfaqen për të cilën është kërkuar vërtetimi i pronësisë në atë mënyrë që tani e tutje nuk do të qëndroj sipërfaqja prej 5658 m² por e njëjta do të zvogëlohet dhe do të qëndroj në sipërfaqen prej 4411 m². Përndryshe në pjesët tjera në tërësi mbetem sipas deponimeve në padi dhe kërkesëpadi vetëm do të shtoja edhe rrethanën se kjo pronë është fituar edhe në bazë të mbajtjes me mirëbesim. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkoj.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit deklaroi: e kundërshtoj edhe më tutje padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ndërsa ia lë gjykatës të vendos sipas provave materiale të administruara. Shpenzimet nuk i kërkoj pasi që më janë paguar.

Gjykata, pas administrimit të provave konform neneve 7 dhe 8 të LPK-së, të njëjtat i lexoi një nga një dhe atë: ekspertiza gjeodete C.nr.292/2012 e datës 28.04.2014, kopja e planit e përpjestuar 1:2500, çertifikata e pronësisë me numër të njësisë kadastrale P-71208042-010008-0 e datës së lëshimit 13.05.2014, çertifikata e pronësisë me numër të njësisë kadastrale P-71208042-01008-0 e datës 05.12.2012, procesverbali i daljes në vend 28.04.2014, dëshmia e dëshmitarëve dhe _____ që të dy nga fshati Vinarc i Poshtëm-Komuna e Mitrovicës dhe pas administrimit të provave konstatoj se:

Nuk është kontestues fakti se paditësi _____ nga fshati _____ i Poshtëm-Komuna e Mitrovicës e ka blerë parcelen kadastrale _____ të cekur në pikën II nga i padituri _____ ia ka paguar çmimin e shitblerjes dhe të njëjtën e posedon në mënyrë të papenguar që nga viti 1983.

Gjykata në mungesë të provave tjera për të vërtetuar pretendimet e palës paditëse lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë, u bazua në deklaratat e dëshmitarëve të dhëna në seancën e datës 03.07.2014, ku të njëjtit deklaruan se paditësi e ka blerë parcelën kontestuese diku rreth vitit 1983, e ka paguar çmimin e shitblerjes dhe ka hy në posedim të saj dhe e shfrytëzon atë në mënyrë të papenguar që nga ajo kohë.

Këtyre deklaratave gjykata ua fali besimin e plotë pasi që këta dëshmitar u paralajmëruan nga ana e gjykates se dëshmia e rrejshme paraqet vepër penale.

Gjykata lidhur me sipërfaqen që mbanë paditësi në terren e që është e ndryshme me fletën poseduese ia fali besimin e plotë ekspertizës së ekspertit Ing.Nehat Sahiti të dhënë me datë 28.04.2014, pasi që e njëjta ishte e qartë dhe e përpiluar në mënyrë profesionale.

Prandaj, gjykata bazuar në nenet 20, 21, 28, 30 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike i vitit 1980 vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Gjykata, lidhur me shpenzimet e procedurës u bazua në nenet 81 par.2, 449, 450, 451 par.1 të LPK-se .

Gjykata, aktgjykimin e saj e mbështeti në nenin 143 par.1 të LPK-se.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

C.nr.292/2012 date 11.08.2014

GJYQTARI

Faton Ademi



UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate.